



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 maj 2021
Nr.ref.:RK 1773/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI21/21

Parashtrues

Asllan Meka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
Ac. nr. 4385/2020, të 15 dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Asllan Meka, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac. Nr. 4385/2020] të 15 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPP. Nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 32 [E Drejta për Mjet Juridik] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe nenin 1 (Mbrotjtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 janar 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dorëzuar përmes postës më 25 janar 2021.
7. Më 1 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 9 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj që të dorëzojë formularin e plotësuar të kërkesës dhe kopjen e ankesës së tij, të parashtruar në Gjykatën e Apelit.
9. Më 26 mars 2021, Gjykata pranoi formularin e kërkesës nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një Aktvendim të

Gjykatës Themelore dhe ankesë në Gjykatën e Apelit, të cilat nuk i referoheshin procedurës, vendimeve të kontestuara përmes kërkesës së tij, të 27 janarit 2021.

10. Më 29 mars 2021, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
11. Më 28 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 21 prill 2020, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesë në Gjykatë, të regjistruar me numër KI64/20, përmes të cilës kishte kontestuar Aktgjykimin [Rev. nr. 2/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, të nxjerrë në procedurë kontestimore. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; nenin 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata përmes Aktvendimit për Papranueshmëri, të 22 korrikut 2020 kërkesën e parashtruesit të kërkesës e shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
13. Rrjedhimisht, Gjykata shkurtimisht do të përmbledhë faktet e rastit KI64/20, të cilat i paraprijnë fakteve, respektivisht procedurës së zhvilluar përmbartimore që është objekt i vlerësimit të kërkesës së tanishme të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën kontestimore

14. Sipas shkresave të lëndës, më 26 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës, së bashku me tre persona të tjerë, E.M, S.M dhe SH.K.M, si huamarrës, kishin nënshkruar kontratën mbi huan me paditësin A.K., si huadhënës, sipas së cilës pranuan huan në shumë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, me afat të kthimit prej 1 (një) viti.
15. Në një datë të paspecifikuar, si rezultat i moskthimit të borxhit nga huamarrësit, huadhënësi A.K kishte paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejshme: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit të kërkesës dhe huamarrësve të tjerë për kthimin e borxhit prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro.
16. Më 2 mars 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 301/14] miratoi në tërësi kërkesën e paditësit A.K, dhe detyroi parashtruesin e kërkesës dhe të paditurit tjerë E.M, S.M dhe Sh.K.M, që në emër të kthimit të borxhit në bazë të kontratës mbi huan, solidarisht t'ia paguajnë paditësit shumën prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, me kamatë përkatëse ligjore, e cila fillon të rrjedhë nga data 24 mars 2010 e tutje, e deri në pagimin definitiv, në lartësi të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë.
17. Më 8 prill 2015, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.

18. Më 8 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 1774/2015] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të paditurve tjerë, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
19. Më 27 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore.
20. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 2/2020] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës. Ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme ishte objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në rastin KI64/20, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e tanishme

21. Në një datë të paspecifikuar, huadhënësi A.K., në cilësinë e kreditorit, te Përmbaruesi Privat parashtroi propozimin për përmbarim të dokumentit përmbarimor, respektivisht Aktgjykimit [C. Nr. 301/14] të 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore, i cili ishte bërë i formës së prerë më 8 nëntor 2019 dhe i ekzekutueshëm nga 12 dhjetori 2019.
22. Më 18 dhjetor 2019, Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit [P. Nr. 1222/20] lejoi përmbarimin e pagesës së shumës së borxhit, të përcaktuar me Aktgjykimin [C. Nr. 301/14] e 2 marsit 2015, të Gjykatës Themelore.
23. Më 23 dhjetor 2019, kundër Urdhrit të lartcekur të Përmbaruesit Privat, parashtruesi i kërkesës, E.M, S.M dhe SH.K.M (në tekstin e mëtejme: debitorët tjerë) parashtruan prapësim në Gjykatën Themelore. Ndërsa, më 13 shkurt 2020, kreditori parashtroi përgjigje ndaj prapësimit të parashtruesit të kërkesës.
24. Më 15 korrik 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [PPP. Nr. 52/2020] refuzoi si të pabazuar prapësimin kundër Urdhrit për Përmbarim të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe debitorët tjerë.
25. Gjykata Themelore, ndër të tjerash kishte arsyetuar se:

“[...] në rastin konkret propozimi për përmbarim është ushtruar sipas dokumentit përmbarimor-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C. Nr. 301/14 i datës 02.03.2015, i plotfuqishëm me datën 08.11.2019, i ekzekutueshëm me datën 12.12.2019, i cili vendim është dokument përmbarues në bazë të nenit 23 par.1 ku theksohet se “vendimi gjyqësor me të cilin është dhënë urdhër përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm, po qe se ka marrë formën e prerë, dhe po qe se ka skaduar fati për përmbushje vullnetare.”

26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, dhe debitorët tjerë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

27. Më 15 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 4385/2020] ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe debitorëve tjerë e refuzoi si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP. Nr. 52/20] të 15 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore.
28. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të saj konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës dhe debitorëve tjerë se Aktvendimi i Gjykatës Themelore është i paqartë dhe jo preciz është i pabazuar duke arsyetuar se propozimi për përmbarim është përpiluar duke u bazuar në titullin ekzekutiv, respektivisht Aktgjykimin [C. Nr. 301/14] e 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore, i cili ishte bërë i formës së prerë nga 8 nëntori 2019 dhe i ekzekutueshëm nga 12 dhjetori 2019, dhe si tillë, i njëjti bazuar në dispozitat ligjore plotëson kriteret e dokumentit përmbarues.
29. Së dyti, përkritazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës dhe debitorëve tjerë se Gjykata Themelore ka vendosur në kundërshtim me nenin 73 [Vendosja sipas prapësimit] të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, respektivisht pretendimit se Gjykata Themelore ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, Gjykata e Apelit arsyetoi se *"[...] nuk mund ta pranoj një pretendim të tillë si të bazuar, pasi që në procedurën përmbarimore gjykata lidhur me prapësimin mund të vendosë jashtë seancës gjyqësore konform nenit 73 të LPP-së. Gjykata përjashtimisht mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme mbajtjen e seancës gjyqësore për të vendosur lidhur me prapësimin."*
30. Së treti, përkritazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës dhe debitorëve tjerë se të njëjtit kanë parashtruar edhe revizion pranë Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit duke iu referuar nenit 213 të Ligjit për Procedurën Kontestimore vlerësoi se revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, respektivisht Aktgjykimit [C. Nr. 301/14] të 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore.
31. Në fund, Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës dhe debitorëve tjerë, të parashtruara në ankesën e tyre, dhe që ndërliidhen me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe atij të Procedurës Kontestimore janë të pabazuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 32 [E Drejta për Mjet Juridik] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
33. Parashtruesi i kërkesës iu referohet neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së duke pretenduar shkelje të të drejtave themelore të garantuara me

këto nene, mirëpo pa shtjelluar dhe arsyetuar fare se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me këto nene të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Bazuar në shkresat e lëndës të kërkesës KI64/20, parashtruesi i kërkesës të njëjtat pretendime i ngrit edhe në kërkesën e tanishme.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Gjykatës së Apelit, të nxjerrë në procedurë përmbarimore *“i kanë mbrojtur fajdet”*. Ai thekson se të hollat i janë dhënë me fajde, dhe se arsyetimet e dhëna në aktvendimet e gjykatave të rregullta janë të paqarta dhe kontradiktore.
35. Tutje parashtruesi pretendon se në: (i) në procedurë ishin katër (4) të paditur dhe në gjykatë kurrë nuk janë ftuar i padituri i dytë, i tretë, dhe i katërt por vetëm i padituri i parë; (iii) gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se ku janë marrë dhe dhënë të hollat; dhe se (iv) kontratat janë fiktive dhe të imponuara. Sipas parashtruesit të kërkesës asgjë nuk ishte vërtetuar nga ana e gjykatave dhe për këtë arsye padia është dashtë të hedhet poshtë. Në lidhje me këto pretendime të lartcekura, parashtruesi i kërkesës nuk precizon nëse këto pretendime i referohen procedurës kontestimore apo procedurës përmbarimore, e cila është objekt i vlerësimit të kërkesës së tanishme.
36. Në vijim, parashtruesi i kërkesës edhe në kërkesën e tij të tanishme ripërsërit se paditësi ka ushtruar padi në vitin 2014 ndërsa ai obligohet që ta paguaj kamatën nga viti 2003. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky borxh është parashkruar por kundërshtimi i parashkrimit nuk është trajtuar. Sipas parashtruesit *“Çështja e parashkrimit deri me datën 22 mars 1999 ka qenë e rregulluar me LMD [Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve], neni 371 , dhe afati i parashkrimit ishte 5 (pesë) vjet. Andaj, dispozita e nenit 34. të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore "Gazeta zyrtare e RFJ" 31/93 e dt. 18.06.1993 e cila ka hype ne fuqi me dt. 25.06.1993 e cila dispozitë e rregullon ndryshe atë lëmi nga ajo e rregulluar me dispozite ligjore në fuqi deri me 22 mars 1999 është dispozitë e pa aplikueshme, e cila as përjashtimisht nuk mund të aplikohet, pavarësisht se është jodiskriminuese, prej nga del se neni 34 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore "Gazeta zyrtare e RFJ" 31/93 i dt. 18 qershor 1993 është ligj për Kosovë i pa aplikueshëm”*.
37. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon vendosjen e masës së përkohshme, respektivisht kërkon *“që mos të i mundësohet kreditorit që të realizon qëllimin e vet në mënyrë kundërligjore duke marrë të hollat tona në mënyrë të kundërligjshme.”*
38. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohen dhe të shpallen *“antikushtetuese”* aktvendimet e Gjykatave të rregullta.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 6

E drejta për një proces të rregullt

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]*

NENI 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Protokoll shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

NENI 1 **Mbrojtja e pronës**

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

Neni 22 *Dokumenti përmbarues*

1. Dokumente përmbaruese janë:

*1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;
[...]*

Neni 71 *Shkaqet e prapësimit*

1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse:

1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

41. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

42. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Ac. Nr. 4385/2020] të 15 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
43. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në mënyrë specifike, rregulli 39 (1) (d) dhe (2) përcaktojnë që:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...] dhe

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

44. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij, të regjistruar në Gjykatë me numër KI64/20 kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. Nr. 2/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, të nxjerrë në kuadër të procedurës kontestimore, përmes të cilit kërkesa e tij për revizion ishte refuzuar si e pathemeltë. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që në këtë procedurë kontestimore përmes Aktgjykimit [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015 ishte konstatuar dhe për pasojë ishte vendosur që parashtruesi i kërkesës dhe të paditurit e tjerë detyrohen që huadhënësit A.K. solidarisht t'ia paguajnë borxhin në shumë prej 35, 000.00 euro. Ky konstatim dhe vendim i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar përmes Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme. Parashtruesi i kërkesës, aktgjykimet e nxjerra në kuadër të procedurës kontestimore i kishte kontestuar përmes kërkesës së tij KI64/20, të dorëzuara në Gjykatë, më 21 prill 2020. Rrjedhimisht, Gjykata përmes Aktvendimit të saj për Papranueshmëri, të 22 korrikut 2020, pas shqyrtimit dhe elaborimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kërkesën e tij e kishte shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.
45. Përderisa në kërkesën e tanishme, të parashtruar në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Ac. Nr. 4385/2020] të 15 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PPP. Nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore, të nxjerrë në procedurë përmbarimore. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata po ashtu rikujton se procedura përmbarimore ishte iniciuar nga A.K, huadhënësi, në cilësinë e kreditorit në këtë procedurë, si rezultat i Aktgjykimit të lartcekur [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015, të Gjykatës Themelore, i nxjerrë në procedurë kontestimore, përmes të cilit ishte përcaktuar që parashtruesi i kërkesës dhe të paditurit tjerë ishin detyruar që A.K. në mënyrë solidare ti paguajnë borxhin në shumë prej 35, 000.00 euro. Ky Aktgjykim, i Gjykatës Themelore ishte bërë i formës së prerë më 8 nëntor 2019 dhe i ekzekutueshëm nga 12 dhjetori 2019, dhe si i tillë sipas Përmbaruesit Privat dhe gjykatave të rregullta në kuadër të procedurës përmbarimore përbënte dokument përmbarues. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit Përmbarues, kishte lejuar përmbarimin e Aktgjykimit [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015, të Gjykatës Themelore. Si rezultat i prapësimit, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe debitorët tjerë, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. Nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020 kishte refuzuar prapësimin kundër Urdhrit Përmbarues. Në vijim, si rezultat i ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe debitorët tjerë, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj [Ac. Nr. 4385/2020] të 15 dhjetorit 2020 ankesën e tyre e refuzoi si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
46. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konstaton se objekt i vlerësimit në rastin konkret është Aktvendimi [Ac. Nr. 4385/2020] i 15 dhjetorit 2020, i Gjykatës së Apelit, në lidhje me Aktvendimin [PPP. Nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore, të nxjerra në procedurë përmbarimore.
47. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tanishme pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; nenit 32 të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

48. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata, duke u bazuar në shkresat e lëndës të kërkesës KI64/20, vëren se parashtruesi i kërkesës të njëjtat pretendime i ngrit edhe në kërkesën e tanishme. Sikurse edhe në kërkesën KI64/20, parashtruesi i kërkesës edhe në kërkesën e tanishme ripërsërit se në rastin e tij nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke pohuar se kontratat ishin fiktive dhe të imponuara, dhe se këtu kemi të bëjmë me fajde dhe jo me huadhënie. Parashtruesi i kërkesës vazhdon duke theksuar se Gjykata Supreme, në kuadër të procedurës kontestimore ka bërë interpretim të gabuar të ligjit kur ka vendosur që të paguhet kamata nga viti 2003, për shkak se sipas tij *“padia është bërë në vitin 2014 dhe se gjithmonë kamata aplikohet nga dita e parashtrimit të padisë.”* Gjykata vë në pah se pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës i referohen procedurës kontestimore, e cila procedurë ishte objekt i çështjes së kërkesës KI64/20, dhe në lidhje me këtë të fundit Gjykata kishte konstatuar se të njëjtat ishin pretendime të pabazuara në baza kushtetuese.
49. Prandaj, bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës iu referohet neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së duke pretenduar shkelje të të drejtave themelore të garantuara me këto nene, mirëpo pa shtjelluar dhe arsyetuar fare se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Në lidhje me vendimet e kontestuara në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohen dhe të shpallen “antikushtetuese Aktvendimet gjyqësore.”
50. Për sa i përket procedurës së zhvilluar përmbartimore, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore, si rezultat i prapësimit të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe debitorët tjerë, përmes Aktvendimit të saj [PPP nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020, ndër të tjera, kishte theksuar se propozimi për përmbartim është bazuar në Aktgjykimin e formës së prerë dhe të ekzekutueshëm Aktgjykimin [C. Nr. 301/14] e 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore, i cili në bazë të nenit 22 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përben dokument përmbartues.
51. Në adresimin e pretendimeve të ngritura me ankesë, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj [PPP. Nr. 52/2020] të 15 korrikut 2020, ndër të tjera, kishte vërtetuar se propozimi për përmbartim është përpiluar duke u bazuar në titullin ekzekutiv, respektivisht Aktgjykimin [C. Nr. 301/14] e 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore, i cili ishte bërë i formës së prerë nga 8 nëntori 2019 dhe i ekzekutueshëm nga 12 dhjetori 2019, dhe si tillë, i njëjti bazuar në dispozitat ligjore plotëson kriteret e dokumentit përmbartues.
52. Ashtu siç u cek edhe më lart, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij të tanishme ka pretenduar shkeljen e neneve 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore të nxjerrë në procedurë përmbartimore. Gjykata rithekson se pretendimet e tij të ngritura në kërkesën e tij i referohen procedurës kontestimore, për të cilat pretendime Gjykata përmes

Aktvendimit të saj për Papranueshmëri në rastin KI69/20 ka konstatuar se janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç përcaktohet me rregullin 29 (2) të Rregullores së Punës.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, e cila mbështetet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) i mundëson Gjykatës që të shpallë të papranueshme pretendime të caktuara si “qartazi të pabazuara” në baza kushtetuese, nëse të njëjtat, janë “të pambështetura apo paarsyetuara” (shih rastin e Gjykatës KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 84). Gjykata konsideron se përkitazi me këtë kategori pretendimesh, ky është rasti. Kjo sepse, parashtruesi i kërkesës vetëm e ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, duke mos ofruar asnjë arsytim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tij rreth mënyrës se si Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, përfshirë edhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore, të nxjerra në procedurë përmbarimore, mund të kenë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
54. Gjykata gjithashtu rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsytim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31, KI124/20 parashtrues *MuhamedAli Ceysülmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 41).
55. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 85, dhe KI124/20 parashtrues *MuhamedAli Ceysülmedine*, i cituar më lart, paragrafi 42).
56. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, janë pretendime “të pambështetura apo paarsyetuara”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

57. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës parashtroi para saj kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme duke kërkuar që *“që mos të i mundësohet kreditorit që të realizon qëllimin e vet në mënyrë kundërligjore duke marrë të hollat tona në mënyrë të kundërligjshme.”*
58. Gjykata tani më konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.
59. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masa e Përkohshme) të Ligjit dhe pikën a) të paragrafit 4 të rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamet Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).
60. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme si qartazi e pabazuar, në bazë kushtetuese, dhe se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (d) dhe (2), 57 (4) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban
Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi

